



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 141/6 prot.

Tiranë, më 13.4.2021

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 332, datë 12.1.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Lindita Male (Ziguri)
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 30.3.2021 është njoftuar vendimi nr. 332, datë 12.1.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit znj. Lindita Male (Ziguri), prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c” e aneksit të Kushtetutës, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 31.3.2021, është depozituar akti: “Rekomandim për paraqitje ankimi”, nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor, nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, datë 31.3.2021, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 332, datë 12.1.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Male (Ziguri), ushtron detyrën e prokurores në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Lindita Male (Ziguri), ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si *ILDKPKI*), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si *DSIK*) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim referuar si *KLP*), nga të cilat rezulton se:

2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit Lindita Male (Ziguri)*”² ka referuar se:

- i. Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Ka mosdeklarime ndër vite dhe mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të ardhurat;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 **DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit znj. Lindita *** Male (Ziguri)³, ka referuar: “*Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita *** Male (Ziguri)*”.

2.3 **KLP**, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit Raportin⁴ për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, Lindita Male (Ziguri).

3. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaramëve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, ligjshmërinë e

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

² Shkresa e ILDKPKI me nr. ***/*** prot., datë ***.10.2018.

³ Shkresa e DSIK-së nr. *** prot., datë ***.10.2017, e deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. ***, datë ***.7.2020.

⁴ Raport i KLP-së nr. *** prot., datë ***.9.2020.

të ardhurave, shpenzimet etj., për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioni, pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat dhe faktet e dala nga hetimi administrativ, provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e barrës së provës, ka arritur në përfundimin se: [...] *Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të sakta në Deklaratën Vetting për kriterin e kontrollit të pasurisë. Pasaktësitë e konstatuara gjatë hetimit, lidhur me veprime të kryera nga bashkëshorti i saj, u vlerësuan nga trupi gjykues se nuk lidhen me subjektin e rivlerësimit dhe veprimtarinë e saj si prokurore, e nuk mund, e as duhet, të ndikojnë në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, në këndvështrim të procesit të saj të rivlerësimit. Nga vlerësimi i provave dhe i shpjegimeve në raport me Deklaratën Vetting, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti rivlerësimit, znj. Lindita Male (Ziguri), ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë [...] ⁵. Në këto kushte, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Male (Ziguri), ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.*

3.2 Për kontrollin e figurës. Referuar nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në konsideratë të verifikimit dhe të konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmërinë e subjektit, edhe pas hetimit administrativ, ka arritur në përfundimin se: [...] *Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së, informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti ka plotësuar formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, të jetë i përfshirë apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë, e gjen të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës [...] ⁶. Në këto kushte, Komisioni, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Male (Ziguri), ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.*

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. Referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga KLP-ja, denoncimet e depozituara në Komision dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se: [...] *Trupi gjykues vlerëson se, në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe konsiderohet “e aftë”. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. [...] ⁷. Për sa më sipër, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Male (Ziguri), ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.*

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, Komisioni, me vendimin nr. 332, datë 12.1.2021, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, me shumicë votash, ka vendosur:

⁵ Referohuni arsyetimit të Komisionit në faqen 40-41 të vendimit.

⁶ Referohuni arsyetimit të Komisionit në faqen 41 të vendimit.

⁷ Referohuni arsyetimit të Komisionit në faqen 44 të vendimit.

“1.Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Male (Ziguri), prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

5. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”⁸ e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2⁹ e ligjit nr. 84/2016, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 31.3.2021, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë: “Rekomandim për paraqitje ankimi” ndaj vendimit nr. 332, datë 12.1.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit znj. Lindita Male (Ziguri) (bashkëlidhur këtij ankimi).

6. Në mënyrë të përmbledhur, objekti dhe çështjet e trajtuara në këtë Rekomandim lidhen me rezultatet e dala nga hetimi administrativ në raport me përfundimet e arritura nga Komisioni, më konkretisht për çështjet si vijon: (i) Aktiviteti tregtar i personit të lidhur (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit) në periudhën 2005-2007 dhe çështje të lidhura me të; (ii) Hua të marra nga personi i lidhur (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit), nga palë të treta, në periudhën 1993-1994; (iii) Hua nga personi tjetër i lidhur, në shumën 5.000 euro; (iv) Mungesa e një arsytimi të plotë dhe gjithëpërfshirës nga Komisioni lidhur me çështjet e sipërcituara.

7. Për sa më sipër, ONM rekomandon që Komisionerët Publikë të ankimojnë vendimin e Komisionit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Male (Ziguri). Ky ankim do të mundësojë që Kolegji të: (i) vlerësojë çështjet që lidhen me pasurinë dhe ndikimin e tyre në procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit; (ii) kryejë një analizë të saktë financiare dhe (iii) sigurojë një arsytim të plotë për çështjet në diskutim.

III. Vlerësimi i Komisionerit Publik

8. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

9. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit kontrollues/rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar si Kolegji).

10. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

11. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet

⁸ Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra ... u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit.

⁹ Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë t'i paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.

e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave të administruara.

12. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, në zbatim dhe të rekomandimit të ONM-së, datë 31.3.2021, vlerëson se përfundimet e arritura nga Komisioni për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Male (Ziguri), duket se nuk bazohen në një hetim të gjithanshëm, të plotë dhe shterues për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

13. Komisioneri Publik, sa më lart konstatuar, vlerëson se çështjet që do të gjejnë trajtim në këtë ankim, në referencë të gjendjes që janë aktet, përbëjnë shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

14. Në këto kushte, Komisioneri Publik evidenton dhe parashtron si çështje për gjykim, rrethana dhe fakte ligjore, për të cilat subjektit të rivlerësimit i është kaluar barra e provës apo i janë kërkuar shpjegime, lidhur me: (i) aktivitetin tregtar të personit të lidhur (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit), në periudhën 2005-2007 dhe çështje të lidhura me të; (ii) huamarrje në periudhën 1993-1994, të personit të lidhur z. *** ***, (iii) huamarrje në shumën 5.000 euro, nga shtetasi *** ***, deklaruar si burim për pasurinë apartament banimi me sip. 68.8 m², Tiranë; (iv) mungesa e një arsyetimi për vlerësimin tërësor të kriterëve të rivlerësimit.

15. Në referencë të përmbajtjes të pikës 2, të nenit 4, pikës 1, të nenit 59 dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik vlerëson se gjykimi i rrethanave ligjore dhe i fakteve të mësipërme nga ana e Kolegjit është i nevojshëm, duke kryer njëkohësisht një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve të rivlerësimit.

16. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 332, datë 12.1.2021, të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.

IV. Analiza e shkaqeve të ankimit

IV.A. Kontrolli i pasurisë

17. Në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 - 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudencës së Kolegjit, Komisioneri Publik mban në konsideratë se gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi sipas nenit 179/b, të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit ("Vetting" dhe ato periodike). Në çdo rast, subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

18. Komisioneri Publik, në vlerësim të kriterit të pasurisë, është bazuar në aktet e administruara dhe rrethanat e çështjes, të cilat, në gjendjen që janë, paraqesin nevojën për riçeljen e hetimit gjyqësor, pasi konstatohet se hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk ka qenë i gjithanshëm, i plotë dhe shterues.

19. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Male (Ziguri), është subjekt deklarues për herë të parë në vitin 2003 dhe, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratat e interesave private periodike për vitet 2003 - 2017 (në vijim DV -20--) dhe në datën 25.1.2017 ka dorëzuar në ILDKPKI Deklaratën “Vetting”, sipas shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016.

20. Në funksion të nenit D të aneksit të Kushtetutës, për kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaramit dhe burimit të ligjshëm të pasurive, nga shqyrtimi dhe krahasimi i Deklaratës “Vetting” me deklaratat periodike vjetore, rezulton si vijon:

21. Mbi aktivitetin tregtar të personit të lidhur, z. * *** (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit) në periudhën 2005-2007 dhe çështje të lidhura me të**

21.1 Në *D-Vett.*, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, z. ***, nuk kanë deklaruar angazhime dhe veprimtari private për periudhën 2005 – 2007.

21.2 Në DV-2006, subjekti i rivlerësimit në rubrikën: “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” ka deklaruar: *Detyrim tatimor i planifikuar për licencën e firmës “***” sh.p.k., Përmet, në shumën 320.000 lekë. Dt. e fillimit 2006 – dt. e mbarimit 31 dhjetor 2006 (b/shorti).*

21.3 Nga aktet e administruara në dosje të Komisionit rezulton si vijon:

21.3.1 Qendra Kombëtare e Biznesit¹⁰ konfirmon se shtetasi *** *** figuron të ketë qenë administrator, ortak i vetëm dhe likuidator në shoqërinë “*** ***” sh.p.k, me NIPT ***, aktualisht me status i çregjistruar.

21.3.2 Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër¹¹, konfirmon se shtetasi *** *** *** figuron i regjistruar si administrator i subjektit “*** ***” sh.p.k., me NIPT ***, me datë regjistrimi ***.7.2005. DRT Gjirokastër ka informuar se për këtë subjekt nuk disponohen të dhëna tatimore në sistemin C@TS dhe në arkiv.

21.4 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka deklaruar se: *“Pas një periudhe 10-vjeçare në gjendje pasive, shoqëria “*** ***” sh.p.k., me NIPT ***, ka riçelur aktivitetin në korrik të vitit 2005, me lidhjen e një marrëveshjeje bashkëpunimi me shtetasin ***. ***, administrator i firmës së ndërtimit “***” sh.p.k. Aktiviteti është çelur me qëllim ndërtimin e një shtese pallati ekzistues 5 kat., në rrugën “*** ***” nga Firma “***” sh.p.k., me lejen e ndërtimit nr. ***, datë ***.5.2004, ku shoqëria “*** ***” sh.p.k. do të menaxhonte aktivitetin. Në kohën e riçeljes së aktivitetit, punimet e shtesës kishin ngecur në soletën e katit të dytë. Bazuar në pikën 6 të marrëveshjes, shoqëria “*** ***” sh.p.k. do t'i siguronte mjetet financiare nëpërmjet një kredie që do të merrej nga Banka ***, e cila nuk u aprovua”.*

¹⁰ Shkresa e QKB nr. ***/*** prot., datë ***.6.2020, drejtuar Komisionit.

¹¹ Shkresa e DRT Gjirokastër nr. ***/*** prot., datë ***.6.2020, drejtuar Komisionit.

21.5 Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ, lidhur me aktivitetin tregtar të shoqërisë “****” sh.p.k., ndër të tjera, janë administruar:

21.5.1 Leje ndërtimi nr.***, datë ***.12.2004, në emër të subjektit ndërtues “****” sh.p.k (formulari nr. 4). Me vendim të KRRT-së nr. ***, datë ***.5.2004, është miratuar leje ndërtimi për objektin godinë banimi dhe shërbimi 5 kat. në rr. “**** ****” në favor të subjektit ndërtues “****” sh.p.k, në pronë të familjeve ***, ***, ***, ***, ***.

21.5.2 Kontratë bashkëpunimi për sipërmarrje ndërtimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.7.2005, me palë *** ***, administrator i shoqërisë “**** ****” sh.p.k., në cilësinë e investitorit dhe *** ***, administrator i shoqërisë ndërtimore “****” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit, me objekt ndërtimin e ndërtesës për shërbim dhe banim në një truall në rr.“**** ****”, Tiranë.

21.5.3 Kontratë porosie nr. *** rep., *** kol., datë ***.11.2006, me palë sipërmarrëse shoqëria “**** ****” sh.p.k., e cila merr përsipër ndërtimin dhe shitjen në favor të porositësit z. *** **** të dy apartamenteve me strukturë 2+1 dhe sip. 125 m² secili, në vlerën totale 225.000 euro. Në nenin 3, pika 3.2 të kësaj kontrate parashikohet sa vijon: *“Kjo shumë do të paguhet nga porositësi me këste të përcaktuara si më poshtë vijon: 1. Sot në datën e lidhjes së kësaj kontrate nga porositësi z. *** ****, është shuma prej 40.000 euro, pagesë e cila do të pasqyrohet me mandat pagesë. 2. Pjesa tjetër e detyrimit do të likuidohet në momentin e akordimit të kredisë nga banka në të cilën do të aplikojë për kredi porositësi.*

21.5.4 *** Bank¹² konfirmon se, në llogarinë e klientit *** ***, është kredituar në datën ***.1.2007, shuma 99.000 euro, nga llogaria e shtetasit *** **** ***, me përshkrim *“blerje apartamenti nga *** ***, kalim në favor të *** ***, administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë *** sh.p.k.”*. Kjo shumë është tërhequr *cash* nga llogaria bankare e bashkëshortit të subjektit, po në datë ***.1.2007.

21.5.5 Mandat arkëtimi nr. ***, datë ***.1.2007, lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., me anë të të cilit paguhet në favor të z. *** **** shuma 99.000 euro, me përshkrimin; *“anulim kontratë porosie pallat. ‘**** ****’ ”*.

21.5.6 Deklaratë noteriale nr. *** rep., *** kol., datë ***.3.2016, me anë të së cilës shtetasi *** **** deklaroi se ka lidhur një kontratë porosie për apartament banimi dhe dyqan, në shumën 99.000 euro, me shoqërinë *** sh.p.k., përfaqësuar nga administratori i shoqërisë *** **** dhe, në muajin janar 2007, deklaroi se e ka zgjidhur kontratën e porosisë, duke marrë pas shumën 99.000 euro.

21.5.7 Raport kontrolli, datë ***.5.2007, të ushtruar nga Dega e Tatim-Taksave Përmet, nga ku ka rezultuar: *“...subjekti ‘****’ sh.p.k., sipas dokumentacionit në dosjen përkatëse dhe NIPT-it të marrë ushtron aktivitetin e tij në ndërtimin e një objekti për shërbime dhe banimi në rr. ‘**** ****’, Tiranë, që nga gushti i vitit 2005 dhe në vazhdim... Bilanci së bashku me anekset përkatëse, Deklaratë e realizimit dhe derdhjes së tatim-fitimit së bashku me dokumentacionin përkatës, që kërkohej në zbatim të legjislacionit dhe udhëzimeve të DPT, për vitin 2005, nuk janë dorëzuar në zyrat përkatëse të DTT Përmet ... Për vitin 2006 deri në muajin dhjetor gjithë F.D.P janë me deklarime zero dhe nuk ka derdhur asnjë lloj detyrimi*

¹² Shkresa e *** Bank nr. ****/**** prot., datë ***.10.2020.

për t. fitimi, t.v.sh-në dhe kontributet. Nuk disponohen as librat e blerjes dhe shitjes dhe asnjë dokumentacion për objektin në ndërtim si situacione të tjera. Po kështu deri më sot që kontrollohet nuk është dorëzuar bilanci për vitin 2006...

... u kontrollua gjendja faktike e veprimtarisë ekonomike të subjektit në lidhje me NIPT sekondar të marrë dhe rezultoi se në këtë objekt ishin kryer punimet përkatëse. Objekti ndodhej në fazën e ndërtimit të plotë konstruktiv dhe janë mbyllur e ndarë me tulla, si dhe kryer suvatimet në pjesën më të madhe të tij. Pra, situata e ndërtimeve faktike ishte në 2 katet e para në ndërtim vetëm konstruksion, kurse në 9 katet e tjera ishin përfunduar, konstruksioni, ndarja e mbyllja me tulla dhe suvatimet përkatëse... Në këto kushte, subjektit iu kërkua gjithë dokumentacioni i objektit që ndërtohej nga ana e tij dhe ai dispononte vetëm një kontratë bashkëpunimi me sipërmarrje në ndërtim, si dhe leja e ndërtimit nga bashkia Tiranë, të dhënë në emër të shoqërisë “***” sh.p.k., me të cilën ka një kontratë sipërmarrje. iu kërkuan dokumentacioni në lidhje me punimet e kryera deri në dhjetor 2006 dhe nuk disponohej asnjë lloj, si në lidhje me blerjet dhe punimet e kryera ashtu dhe me shitjet (situacionet e ndryshme mujore progresive)”.

21.6 Referuar rezultateve të hetimit¹³, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit, znj. Male, barrën e provës për të dhënë shpjegime apo paraqitur prova të reja për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, ndër të tjera, lidhur me: (i) Nga hetimi i Komisionit rezultoi se shoqëria “*** ***” sh.p.k. rezultoi se ka kryer punime në këtë objekt nga gusht 2005 – maj 2007 dhe ka lidhur edhe kontrata sipërmarrjeje për shitje të pasurive në këtë godinë, duke kryer edhe arkëtime në llogari personale; (ii) Nuk janë deklaruar në Deklaratën Vetting të ardhura nga aktiviteti i bashkëshortit, për këtë ndërtim, si dhe shpenzimet për këtë aktivitet; (iii) Nuk provohen me dokumentacion ligjor provues deklaratimet e subjektit për sa kohë pretendohet se kthimi i të ardhurave të marra nga z. *** *** iu kthye nga shoqëria, pa provuar se si u transferuan këto të ardhura nga administratori të shoqëria.

21.7 Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar¹⁴ se: “Shoqëria *** sh.p.k., me NIPT ***, nuk ka zhvilluar asnjëherë aktivitet për ndërtimin e objektit shtesë pallati pesëkatësh, rruga “*** ***”, me lejen e ndërtimit nr. ***, datë ***.12.2004, me vendim të KRRT nr. ***, datë ***.05.2004, të nxjerrë në emër të subjektit ndërtues “***” sh.p.k, ndërtuar në fakt 11 kate. Objekti është ndërtuar tërësisht nga shoqëria “***” sh.p.k, me administrator ***. ***. Nga Shoqëria *** sh.p.k., nuk është bërë asnjë blerje materiali, nuk janë kryer pagesa etj., që lidhen me punime të kryera në objektin në rrugën “*** ***”, fakt që konfirmohet dhe nga dokumentacioni i mbajtur nga organet tatimore. Sipas raportit të kontrollit, me datë ***.5.2007, të Degës së Tatim- Taksave Përmet, nga ana e subjektit disponohej vetëm një kontratë bashkëpunimi me sipërmarrje në ndërtim, si dhe leja e ndërtimit nga Bashkia Tiranë (formulari nr. 4), e dhënë në emër të shoqërisë ***sh.p.k. Në faqen e fundit, të titulluar “Vlerësimi i situatës tatimore”, thuhet se nga ana e subjektit nuk disponohej dhe nuk ishte kryer asnjë shitje deri në datën e kontrollit (Raport kontrolli me dt. ***.5.2007, fq.1, mbajtur nga Dega e Tatim-Taksave Përmet).

¹³ Referohuni rezultateve të hetimit (faqe 20).

¹⁴ Referohuni shpjegimeve rreth rezultateve të hetimit (faqe 7-8).

Gjithashtu, nuk është lidhur asnjë kontratë sipërmarrje për shitjen e pasurive në këtë godinë, përveç asaj me ***, ***, në nëntor 2006, që dhe kjo është anuluar nga vetë ky person si porositës.

Administratori i shoqërisë “****” sh.p.k., ***, ***, është dhe personi që ka aplikuar në emër të tij në dhjetor 2006, për nxjerrjen e Lejes së Legalizimit, aplikim i bërë fshehtas bashkëshortit, i cili dijeninë e ka marrë, rastësisht, vite më vonë nga banorët e pallatit. Në lidhje me objektin është nxjerrë Leja e Legalizimit nr. ***, datë ***.6.2018, në favor të subjektit *** sh.p.k., me përfaqësuese ligjore vajzën e ***. *** (*.***)”.

...Shuma 40.000 euro (dyzet mijë), që përmendet në kontratë, nuk është dorëzuar nga shtetasi ***. ***. Ndërsa lidhur me shumën 99.000 euro, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Pavarësisht se transferimi është bërë në llogari personale të bashkëshortit, qëllimi i shumës ka qenë për aktivitetin e shoqërisë dhe, si e tillë, ka qenë detyrim i tij për ta deklaruar në organet tatimore dhe jo në deklaratën si person i lidhur, pasi nuk është e ardhur apo shpenzim”.

21.8 Komisioni, lidhur me veprimtarinë tregtare të personit të lidhur, z. *** ***, ka arritur në përfundimin se [...] krijoi bindjen se ajo nuk lidhet me subjektin e rivlerësimit dhe as me ushtrimin e detyrës së saj. Bashkëshorti i subjektit ka vepruar si tregtar në mënyrë të pavarur nga subjekti i rivlerësimit. Veprimet e kryera nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, të cilat, për më tepër, nuk kanë sjellë as përfitime në ekonominë e përbashkët familjare, nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e ndonjë mase disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit. Në këtë rast, subjekti i rivlerësimit nuk plotëson kushtet për ta konsideruar mosdeklarimin e transaksionit si fshehje të pasurisë, në kuptim të procesit të rivlerësimit, si dhe asnjë nga kushtet e tjera të parashikuara në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 [...] ¹⁵.

21.9 **Komisioneri Publik**, nga shqyrtimi i akteve në dosje, si dhe në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, datë 31.3.2021, pika 4, germa “a”¹⁶ e tij, vëren se, pavarësisht shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, në gjendjen që janë aktet e administruara në dosje të Komisionit, mbetet e paqartë; (i) gjendja e investimit në objektin e ndërtuar në rr. “**** ***”, Tiranë, si dhe (ii) shpenzimet dhe burimet e të ardhurave që kanë shërbyer për kryerjen e këtij investimi.

21.9.1 Të paqarta mbeten edhe detyrimet e shoqërisë “**** ***” sh.p.k. ndaj të tretëve, ku nga kontrata e porosisë të datës ***.11.2006, me palë porositëse z. *** ***, rezulton se në datën e lidhjes së kësaj kontrate palës sipërmarrëse, shoqërisë “**** ***” sh.p.k. i është

¹⁵ Referohuni arsytimit të Komisionit, në faqen 21 të vendimit.

¹⁶ Në faqen 2-3, prg. a) i Rekomandimit të ONM-së, datë 31.3.2021, citohet: a) **Aktiviteti tregtar i personit të lidhur në periudhën 2005-2007 dhe çështje të lidhura me të.** ... Pavarësisht shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, gjendja e investimit, shpenzimet, burimet e të ardhurave dhe mungesa e dokumentacionit, mbetet e paqartë, sikurse dhe përgjegjësitë e mundshme të shoqërisë “****” sh.p.k., për qëllimet e procesit të vlerësimit të pasurisë. Në vështrim të ONM-së, ndikimi i aktiviteteve të tilla në vlerësimin e pasurisë së subjektit duhet të vlerësohet ashtu siç duhet nga Kolegji.

... Faktet e lartpërmendura dhe dokumentacioni i administruar nuk duken bindëse. Shpjegimet lidhur me shumën 40.000 euro nuk janë në përputhje me atë që parashikon kontrata e sipërmarrjes. Ndërsa, tërheqja e papritur nga kontrata e sipërmarrjes dhe mënyra se si paratë u transferuan nga ***. ***, drejt *** *** dhe nga “****” sh.p.k. drejt ***. ***, në të njëjtën ditë, nuk janë në përputhje me pasojat ligjore dhe ekonomike, që një tërheqje e papritur nga pala tjetër ka mbi aktivitetin e shoqërisë.

Subjekti i rivlerësimit dështoi të jepte shpjegime bindëse lidhur me sa më lart, sikurse dhe Komisioni dështoi në arsyetimin e tij. Çështjet e lartpërmendura mund të çojnë në veprime ligjore fiktive të dyshuara, të cilat, në vështrim të ONM-së duhet të hetohen dhe vlerësohen siç duhet nga Kolegji.

paguar shuma prej 40.000 euro (neni 3.2, pika 1 e kësaj kontrate), ndërsa subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet rreth rezultateve të hetimit, deklaroi se: “...Shuma 40,000 euro (dyzet mijë) që përmendet në kontratë nuk është dorëzuar nga shtetasi ***. ***”.

21.9.2 Gjithashtu, tërheqja nga kontrata e porosisë së datës ***.11.2006 e z. *** ***, si dhe pagesa në vlerën 99.000 euro, nëpërmjet transfertës bankare në datën ***.1.2007, në favor të z. *** *** dhe kthimi *cash* i kësaj shume, brenda së njëjtës ditë, tek z. *** *** duken si veprime të kryera me qëllim krijimin e pasojave jo të vërteta, të cilat duhen të vlerësohen nga Kolegji.

21.9.3 Sa më sipër, Komisioneri Publik çmon si të nevojshëm një hetim më të plotë dhe të gjithanshëm nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, lidhur me aktivitetin tregtar të shoqërisë “**** ***” sh.p.k., me NIPT ***, si dhe hetimin për konflikte interesi të mundshme të subjektit të rivlerësimit, znj. Male, në ushtrimin të detyrës së saj si prokurore me palët e sipërcituara.

22. Huamarrje në periudhën 1993-1994 të personit të lidhur, z. * *****

22.1 Në *D-Vett.*, personi i lidhur, z. *** ***, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në rubrikën; “*Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë*” deklaroi: (i) Akt-detyrimi për kreditim afatgjatë për investime, me datë ***.9.1994, me *** Banka. Shuma e detyrimit financiar: 1.000.000 lekë. (ii) huamarrje nga të tretë për qëllim të aktivitetit privat, të ushtruar në vitet 1993, 1994, në shumën 16.100.000 lekë.

22.2 Në DV-2006, subjekti i rivlerësimit, znj. Male, në rubrikën; “*Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë*”, deklaroi: detyrime të tjera të prapambetura 16.100.000 lekë, kreditorëve dhe 1.000.000 lekë, Bankës së Kursimeve (viti 1994).

22.3 Në *Deklaratën e parë* (dorëzuar në ILDKPI, më datë ***.3.2004), personi i lidhur, z. ***, deklaroi: detyrime të prapambetura të mbyllura në bilancin e vitit 1994, Përmet. Vlefë 17.000.000 lekë. Detyrim kundrejt Bankës së Kursimit Përmet dhe klientë. Arsyeja e krijimit të detyrimit: Nga aktiviteti tregtar i vitit 1993,1994.

22.4 Referuar rezultateve të hetimit¹⁷, Komisioni i ka kaluar subjektin të rivlerësimit, znj. Male, barrën e provës lidhur me: (i) Shpjegimet e subjektit për huamarrjet, si dhe marrëveshjet e arritura me palët huadhënëse nuk provohen me dokumentacion ligjor provues dhe se këto hua duket të vijojnë të jenë aktuale; (ii) Detyrimi i deklaruar nga personi i lidhur me subjektin, në shumën 1.000.000 lekë, sipas huas së marrë në Bankën ***, nuk përputhet me informacionin e marrë nga ATK; (iii) Personi i lidhur me subjektin nuk ka deklaruar detyrimet e marra përsipër nëpërmjet marrëdhënieve me zëvendësim debitori, në shumën totale 3.917.800 lekë.

22.5 Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka dhënë përgjigje dhe paraqitur dokumentacion në materialin: *Shpjegime ndaj rezultateve të hetimit*¹⁸.

22.6 Komisioni, pasi mori në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit, arriti në përfundimin se: [...] *vlerëson se marrëdhënia e bashkëshortit të subjektit lidhur me aktivitetin*

¹⁷ Referohuni rezultateve të hetimit (faqe 26).

¹⁸ Referohuni; *Shpjegimeve rreth rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit Lindita Ziguri Male*, faqe 9.

e tij tregtar nuk është objekt deklarimi, përveç pjesës së të ardhurave dhe detyrimeve personale që ai mbart, të cilat rezultojnë se janë deklaruar nga subjekti në mënyrë korrekte në Deklaratën Vetting. Po ashtu, nga hetimi nuk ka rezultuar se këto veprimtari të bashkëshortit në marrëdhënien e tij me shoqërinë tregtare të jenë ndikuar nga subjekti i rivlerësimit, apo ajo dhe familja e saj të kenë përfitime ose lidhje të ndryshme interesi me to. Kjo marrëdhënie rezulton të jetë tërësisht objekt i veprimtarisë së një shoqërie tregtare dhe duhet t'i nënshtrohet legjislacionit përkatës, por nuk mund të lidhet me subjektin dhe procesin e saj të rivlerësimit dhe as mund të ndikojë në dhënien ndaj saj të ndonjë mase disiplinore. Në kuptim të procesit të rivlerësimit, subjekti nuk plotëson asnjë nga kushtet e parashikuara nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016[...].¹⁹

22.7 **Komisioneri Publik**, në zbatim dhe të germës “b”, të pikës 4²⁰, të Rekomandimit të ONM-së, datë 31.3.2021, nga shqyrtimi i akteve në dosje konstaton se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk u mbështetën në prova të plota e, për rrjedhojë, nuk janë shteruese. Në këto rrethana, duhet të hetohen dhe shqyrtohen nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, duke hetuar konkretisht lidhur me: (i) çështjet gjyqësore mes huadhënësve dhe personit të lidhur, z. ***, si dhe (ii) konfliktet e interesit të mundshëm të subjektit të rivlerësimit, znj. Male, në ushtrimin të detyrës së saj si prokurore me këta huadhënës.

23. Huamarrje në shumën 5.000 euro, nga shtetasi * ***, deklaruar si burim për pasurinë “Apartament banimi me sip. 68.8 m², Tiranë”**

23.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament banimi me sip. 68.8 m², në qytetin e Tiranës, blerë në vitin 2008, në shumën 38.000 euro, nga të cilat 30.000 euro kredi, 5.000 euro hua pa kontratë dhe pa interes, nga *** ***(daja) dhe 3.000 euro kursime nga të ardhurat nga puna. Kontratë shitblerje nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.4.2008. Vlera 38.000 euro, pjesa takuese 100%.*

23.2 Në DV-2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kontratë shitblerje nr. *** rep., *** kol., datë ***.4.2008, për apartamentin me sip. 68.8 m², në rrugën “*** ***”. Vlera 38.000 euro, pjesa takuese nuk deklarohet.*

23.2.1 Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën; “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *(i) Kredi për blerje apartament banimi, rr. “*** **”, në shumën 30.000 euro, në *** Bank. (ii) Hua në shumën 5.000 euro, për blerjen e apartamentit, dajës tim, *** ***, pa kontratë noteriale, marrë në 18.4.2008, pa interes.*

23.3 Nga aktet e administruara në dosje rezulton se Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Veri,²¹ ka konfirmuar se, në pronësi të subjektit të rivlerësimit,

¹⁹ Referohuni pikës 7.8, faqe 27, të vendimit të Komisionit.

²⁰ Në faqen 3-4, prg. b) i rekomandimit të ONM-së, datë 31.3.2021, citohet: **b) Huat nga palë të tretë në periudhën 1993-1994.** Në D-vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar disa hua të marra nga personi i saj i lidhur në periudhën 1993-1994, të cilat janë deklaruar në Deklaratat periodike, në shumën 17.100.000 lekë. Subjektit të rivlerësimit i është kërkuar të shpjegojë përdorimin e këtyre fondeve, si janë shlyer huat, nëse huadhënësit për huat e pashlyera kanë ndërmarrë hapa ligjorë në gjykatë kundrejt subjektit të rivlerësimit (personi të lidhur) dhe çështje të tjera të lidhura. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë disa shpjegime, mes të cilave, se fondet e marra hua janë përdorur nga personi i lidhur për aktivitetin e tij tregtar, jo për krijimin e pasurive dhe që huat janë konsideruar moralisht të shlyera dhe të zgjidhura mes palëve. Në vështrim të ONM-së, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk u mbështetën nga ndonjë provë, nuk janë bindëse dhe duhet të shqyrtohen dhe vlerësohen më tej nga Kolegji.

²¹ Shkresa e ASHK-së nr.***/*** prot., datë ***.7.2020, drejtuar Komisionit.

rezulton e regjistruar pasuria e llojit apartament, me sip. 68.8 m², vol. ***, faqe ***, Z. K. ***.

23.4 Origjina e kësaj pasurie rrjedh nga kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.4.2008, lidhur midis shoqërisë ndërtuese “*** ***” sh.p.k., në cilësinë e shitësit dhe znj. Lindita Male, në cilësinë e blerësit, me objekt: shitje apartamenti me sip. 68.8 m², kundrejt vlerës 38.000 euro.

23.5 Referuar rezultateve të hetimit²², Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit znj. Male, barrën e provës, ndër të tjera ,si vijon: (i) *Për personin tjetër të lidhur, z. *** ***, nuk provohen me dokumentacion ligjor provues të ardhurat e ligjshme për të dhënë hua në shumën 5,000 euro.*

23.6 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, në shpjegimet përfundimtare lidhur me huan në shumën 5.000 euro, ndër të tjera, ka deklaruar: *“Shuma përfaqëson kursime familjare në vite. Bëhet fjalë për një person në marrëdhënie pune prej 37 vitesh përfshirë dhe aktivitet privat. Në marrëdhënie pune ka qenë dhe bashkëshortja e tij, ***. *** me rreth 33 vite punë... Meqenëse kam mundur të administroj dokumentacion shtesë për të ardhurat familjare të dajos, ***. *** dhe bashkëshortes së tij, ***. ***, të pallogaritura më parë në bilancin familjar të tij, kërkoj që të merret në shqyrtim nga ana juaj.”²³*

23.7 Komisioni, pasi mori në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit, ka arsyetuar si vijon: *“Lidhur me huan në vlerën 5,000 euro, pa kontratë dhe pa interes nga daja i subjektit, z. ***. ***, trupi gjykues, pasi vlerësoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, arrin në konkluzionin se ka pasur mundësi financiare me burime të ligjshme për dhënie e kësaj huaje... Lidhur me shumën 3,000 euro, për plotësimin e shumës totale për blerjen e apartamentit, trupi gjykues vlerëson se shuma prej 312,472 lekë gjendje në llogarinë e pagës së subjektit, në “*** Bank”, në datën ***.12.2006, e tërhequr dhe e mbajtur cash në vitin 2007, dhe e përdorur në vitin 2008, dhe e padeklaruar, nuk mund të pranohet. Nga analiza financiare për vitin 2008, subjekti rezulton me një balancë negative të tillë, e cila nuk mund të vlerësohet se e klasifikon subjektin e rivlerësimit në ndonjë nga kushtet e nenit 33, pika 5, të ligjit nr. 84/2018, duke vlerësuar, gjithashtu, me rezervë shpenzimet jetike në raport me jetën modeste të subjektit të rivlerësimit, të rezultuar gjatë hetimit”.*²⁴

23.8 Në vijim, Komisioneri Publik do të ndalet në trajtimin e burimit të deklaruar 5.000 euro hua, pa kontratë dhe pa interes, nga z. *** ***, për të cilin vlerëson se konkluzionet e arritura nga Komisioni nuk përputhen me aktet e administruara gjatë hetimit administrativ.

23.9 Lidhur me huan në shumën 5.000 euro, marrë nga z. ***. ***. Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ dhe në shpjegimet përfundimtare, ka paraqitur dokumentacion për

²² Referohuni rezultateve të hetimit (faqe 9).

²³ Referohuni; “Shpjegimeve rreth rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit Lindita Ziguri Male”, faqe 4. Bashkëlidhur shpjegimeve përfundimtare, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacion shtesë lidhur me të ardhurat e shtetasve ***, ***, dhe ***, ***, si dhe një akt ekspertimi kontabël nga Kontabilist i Miratuar, z. ***, ***, me datë ***.12.2020.

²⁴ Pika 1.10, faqe 9 e vendimit të Komisionit.

të provuar të ardhurat e realizuar nga familja ***,²⁵ si dhe një Akt Ekspertimi Kontabël, i datës ***.12.2020.

23.10 Nga verifikimi i zërave të analizës financiare të paraqitura në këtë akt-ekspertim, vërejmë se shpenzimet e jetesës nuk janë llogaritur në përputhje me përbërjen familjare të z. ***, ***, që sipas akteve të administruara në dosje të Komisionit²⁶ rezultojnë të jetë e përbërë nga 6 anëtarë. Gjithashtu, këto shpenzime jetese, për vitin 2007, nuk janë llogaritur bazuar në shpenzimet e jetesës sipas standardit të ILDKPKI/INSTAT²⁷.

23.11 Sa më sipër analizuar, përveç sa konstatuar nga Komisioni lidhur me burimin e deklaruar: *kursime në shumën 3.000 euro*, Komisioneri Publik, në zbatim dhe të pikës 4, germa “c”, të Rekomandimit të ONM-së, datë 31.3.2021²⁸, konstaton se në gjendjen që janë aktet, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur (dajës së saj), për t’i dhënë hua subjektit të rivlerësimit shumën 5.000 euro, sa kohë nga aktet e administruara nga Komisioni duket se z. ***, ***, nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për t’i dhënë hua subjektit të rivlerësimit shumën 5.000 euro, që ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit me sip. 68.8 m,² në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

24. Mungesa e një arsytimi për vlerësimin tërësor të kriterëve të rivlerësimit

24.1 Komisioneri Publik, në zbatim të germës “d”, të pikës 4, të Rekomandimit të ONM-së datë 31.3.2021, konstaton se arsytimi i Komisionit lidhur me çështjet e lartpërmendura, përfshirë mungesën e deklarimit nga personi i lidhur i detyrimeve që rrjedhin si rezultat i zëvendësimit të debitorit²⁹ me debitorin e ri z. ***, ***, nuk është i plotë dhe gjithëpërfshirës për përcaktimin e arsyeve të cilat kanë udhëhequr Komisionin në të tilla konkluzione, nisur nga detyrimi për një vlerësim tërësor të kriterëve të rivlerësimit.

V. Kërkimi i ankimit

25. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik në procesin e rivlerësimit, ka të drejtën dhe detyrimin e ushtrimit të kontrollit ndaj vendimeve të dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke vlerësuar nëse

²⁵ Referohuni akteve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 2 dhe në shpjegimet përfundimtare ku, ndër të tjera, janë depozituar: vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare për ***, ***, dhe ***, ***, për vitet 2006, 2007 dhe 2008; nxjerrje llogarie bankare në “**** Bank” në emër të ***, ***, të ardhura nga paga bruto e z. ***, ***, nga “Studio ****” sh.p.k., ***, dhe “****” sh.p.k, sipas “Vërtetimit për bazën e vlerësuar”, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër; të ardhura nga paga bruto e znj. ***, ***, nga “Studio ****” sh.p.k., sipas “Vërtetimit për bazën e vlerësuar”, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër etj.

²⁶ Referohuni dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit në pyetësorin nr. 2, datë 14.10.2020.

²⁷ Bazuar në informacionin e përcjellë nga ILDKPKI, me shkresën nr.*** prot., datë ***.3.2019, shpenzimet e jetesës për vitin 2007 janë në shumën 235.968 lekë/person dhe jo në shumën 136.620 lekë/person.

²⁸ Në faqen 4, prg. c) i rekomandimit të ONM-së, datë 31.3.2021, citohet: *Në këndvështrim të ONM-së, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur për të dhënë hua shumën prej 5.000 euro, e cila ka shërbyer si burim për krijimin e apartamentit në rrugën “****”, Tiranë, siç është deklaruar në D-Vett.*

²⁹ Referohuni shkresës të ATK nr.***/** prot., datë ***.5.2020, drejtuar Komisionit.

vendimmarrja bazohet në një hetim të plotë dhe të gjithanshëm dhe çmim të drejtë të provave të administruara;

26. Në konsideratë të trajtimit të shkaqeve të ankimit, bazuar në parashikimet e nenit 179/b/5 të Kushtetutës, nenit C/2, Ç dhe F/7, të aneksit të Kushtetutës, nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik vlerëson se, në rastin konkret, zbatimi i nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016 mund të rezultojë vetëm pas hetimit të mëtejshëm të këtyre çështjeve;

27. Mbështetur në parashikimin e nenit F, pika 3 dhe 7 e aneksit të Kushtetutës, nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkojmë që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, pas vlerësimit tërësor të procedurave, për subjektin e rivlerësimit, znj. Lindita Male (Ziguri), në përfundim të gjyqimit të çështjes, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 332, datë 12.1.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ose
- Lënien në fuqi të këtij vendimi.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA

I bashkëlidhet këtij ankimi:

- Rekomandimi për ushtrim ankimi i një komisioni prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të ONM-së, nr. 204/1 prot., datë 31.3.2021.

KOMISIONERËT PUBLIKË
Nr. 141/3 Prot.
Datë, më 31 3 2021 112/15

International Monitoring Operation
*Project for the Support to the Process of Temporary
Re-evaluation of Judges and Prosecutors in Albania*



Funded by the European Union

Prot. No. 204/1

Tirana, 31 March 2021

To the
Public Commissioners

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 6,
Tirana
Albania

Case Number **DC-P/TIR/1/33**
Assessee **Lindita Ziguri**

RECCOMENDATION TO FILE AN APPEAL

According to

Article B, paragraph 3, letter “c” of the Constitution of the Republic of Albania, Annex
“Transitional re-evaluation of judges and prosecutors in the Republic of Albania”, and
Article 65, paragraph 2 of the law no. 84/2016 “On the transitional re-evaluation of judges
and prosecutors in the Republic of Albania”

1. Introduction

Assessee Lindita Ziguri, holds the office of the prosecutor at the Prosecution Office of Tirana. She is an assessee pursuant to Article 179/b, paragraph 3 of the Constitution. The decision to confirm the assessee in duty was announced on 12.01.2021.

Based on the reasoning of the Independent Qualification Commission (IQC) for the confirmation in duty of the assessee, the International Observers (IO's) submit a recommendation to appeal the decision for her confirmation in duty.

2. Summary of the recommendation

The IO's recommend the Public Commissioners to file an appeal against IQC's decision to confirm the assessee in duty, based on several asset related shortcomings, that in the view of the IO's are not clearly dealt with in the reasoning of the IQC.

In the assessment of the IO's a different evaluation of the facts and administered documents and reasoning might possibly impact the assessment of the assets of the assessee in such a way that the outcome of the decision of the IQC does not stand.

3. The decision of the IQC

The decision of the IQC to confirm the assessee in duty was based on an assessment of all three pillars. As relates to the assets' assessment, several issues remain unclear as regards the evaluation of the available evidence, notwithstanding the explanations of the assessee and/or the reasoning of the IQC. The panel decided to confirm the assessee in duty with a majority vote, whereas the dissenting panel member voted for dismissal.

4. Reasons for an appeal

The reasons for the recommendation to appeal are summarized as follows:

a) The commercial activity of the related person during 2005-2007 and related issues

- (i) The assessee has not disclosed in the Vetting Declaration or the PDs any activity and income from the business activity of "****" ltd, with sole owner the related person of the assessee, during 2005-2007.

The assessee explained that *** ltd entered into a business agreement with another construction company in July 2005, to build an extension to an existing residential building. According to the assessee, "****" ltd did not substantially perform any business activity, due to the lack of financial means (an expected loan from the *** Bank which was not granted), as well as to disagreement with the partner in business. According to the assessee, the only activity performed by "****" ltd as relates to the construction, was the stipulation

of an off-the-plan contract in November 2006, with **** for the purchase of two premises in the building.

As per information from Permet Tax Office Branch after an audit on “*** ” Ltd, on 05.2007, the company exercised its activity since August 2005 and onwards. The audit report refers to a factual not documented construction of 11 floors, as well as to non-disclosure with the tax office of the activity, in relation to which several fiscal obligations would arise on behalf of the company during this period.

Notwithstanding the explanations of the assessee, the situation on the investment, expenses, sources of income and lack of documentation, remains unclear as well as the eventual liabilities of “*** ” Ltd for the purposes of the asset evaluation process. In the view of the IO’s, the impact of such activities in the asset assessment of the assessee should be duly evaluated by the AC.

(ii) Furthermore, as relates to the off-plan contract, based on the administered documents and explanations of the assessee, “*** ” Ltd would receive from **** on the date of the stipulation (November 2006), 40.000 Eur. It was also found out that the related person, in the quality of the sole owner of “*** ” Ltd, received 99.000 Eur through a bank transfer on 1.2007; on the other hand, “*** ” Ltd issued a payment slip of 99.000 Eur on the same date of the bank transfer, 1.2007, in favour of **** allegedly because **** wanted to withdraw from the off-plan contract.

According to the assessee, her related person never received 40.000 Eur as stipulated in the contract. She also explained that **** withdrew from the off-plan contract; hence he received the exact amount he had transferred to her related person.

The abovementioned facts and administered documents, do not appear convincing. The explanations on the 40.000 Eur are not in line with what the off-plan contract stipulated. Whereas the sudden withdrawal from the off-plan contract and the way money was transferred from **** to **** and from “****” Ltd to **** on the same day, are not in line with the legal and economic repercussions that a sudden withdrawal of a counterpart has on the activity of the company.

The assessee failed to provide convincing explanations on the abovementioned issues, as well as the IQC failed in its reasoning. The abovementioned issue could also lead to a suspicion of fictitious legal actions, which in the view of the IO’s should be investigated and duly assessed by the AC.

b) Loans from third parties during 1993-1994

In the VD, the assessee declared several loans borrowed by her related person during 1993 – 1994, which were duly disclosed in the Periodic Annual Declarations, in the amount ALL 17,100,000.

The assessee was asked to explain the use of the funds, how the loans were paid back over the years, if the unsettled lenders have initiated legal proceedings in court against the assessee, and other related issues.

The assessee provided several explanations, amongst which, that the borrowed funds were used for her related person's company activity, not for creating assets and that the loans were morally considered as settled by the parties. In the view of the IO's the explanations of the assessee, not supported by any evidence, are not convincing, and should be further examined and assessed by the AC.

c) Loan from the other related person in the amount of 5.000 Eur

In the view of the IO's the assessee failed to evidence the financial capacities of the other related person to provide her the loan of 5.000 which served as a source for the apartment in Rr. *** ***, Tirana, as declared in the VD.

The IO's are of the opinion that such a circumstance should be evaluated and assessed by the AC as relates to the impact in the asset evaluation process of the assessee.

d) Lack of adequate reasoning

The reasoning of the IQC as relates to the abovementioned issues, is not complete and comprehensive of the reasons that led the IQC to the respective conclusions. In the case of the related person failing to declare his obligations as substituting debtor, the IQC has not addressed the issue at all.

5. Recommendation

The IO's recommend the Public Commissioners to file an appeal against the decision of the IQC to confirm the assessee in duty.

This appeal would enable the Appeal Chamber to:

- evaluate asset related issues and their impact in the re-evaluation process of the assessee;
- perform an accurate financial analysis;
- provide an adequate reasoning for the issues at stake.

International Observer



International Observer

International Observer